

Aplikimi për leje zhvillimi pranë Njësive të Qeverisjes Vendore

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kryetari i bashkisë është përgjegjës për:

Vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje zhvillimi në territorin administrativ të bashkisë.

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, reduktohen pengesat administrative dhe përmirësohen praktikat e aplikimit për lejet përkatëse.

Sporteli i shërbimit me një ndalesë për veprimtaritë ndërtimore, kujdeset për të gjitha marrëdhëniet ndërmjet palës së interesuar, autoritetit vendor të planifikimit dhe organeve të tjera të administratës publike që kanë detyrimin të japin mendimin e tyre në lidhje me punimet, objekt i kërkesës për leje ndërtimi apo deklaratës për punime paraprake.

Ky shërbim përbën pikën e vetme të kontaktit të palës së interesuar me administratën publike në lidhje me kërkesën për leje dhe ndërhyrjen përkatëse në territor.

Dokumentacioni i nevojshëm:

Dokumentet që duhet të paraqesë pronari ose zhvilluesi për t'u pajisur me leje zhvillimi, janë, si më poshtë (sipas nenit 10 të VKM-së nr. 408 dt. 13.05.2015 "Rregullorja e Zhvillimit të Territorit):

- Kërkesa për leje, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në këtë rregullore dhe në sistemin elektronik të lejeve;
- Dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjes për pronën;
- Mandatpagesa e tarifës së aplikimit.

Hapat e procedurës:

- Kërkesa për leje zhvillimi paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje zhvillimi.
- Autoriteti vendor përgjegjës shqyrton kërkesat për leje zhvillimi, duke bashkërenduar punën, me të gjitha autoritetet publike të specializuara, nëse pasuria për të cilën kërkohet leja e zhvillimit ndodhet në zona apo është objekt me kufizime apo kushtëzime të veçanta sektoriale, për shkak të vlerave monumentale, arkeologjike, natyrore apo mjedisore;
- Nëse dokumentacioni është i plotë, njoftohet kërkuesi që të paguajë, të gjitha tarifën për shqyrtimin e aplikimit nga autoritetet publike që duhet të shprehen në lidhje me kërkesën, në rast se ka të tilla.
- Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda të njëjtit afat, të kryejë plotësimin e dokumentacionit dhe pagesën e tarifave të shërbimit, në rast se ka të tilla.
- Me dërgimin e njoftimeve, pezullohet llogaritja e afatit të shqyrtimit të kërkesës, deri në plotësimin e dokumentacionit dhe/ose pagesës së tarifave nga kërkuesi.
- Nëse subjekti nuk plotëson dokumentacionin ose nuk paguan tarifën e shërbimit brenda afatit të caktuar, autoriteti përgjegjës merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës për leje zhvillimi.

- Të gjitha autoritetet publike, që duhet të shprehen në lidhje me kërkesën, kanë detyrimin t'i dërgojnë autoritetit përgjegjës, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, të dhëna lidhur me përditësimet e infrastrukturës apo ekzistencën e kufizimeve sektoriale të mundshme, lidhur me pronën/zhvillimin e propozuar.
- Në mungesë të përgjigjes brenda afatit 10-ditor, kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje dhe autoriteti përgjegjës ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për leje.
- Brenda 5 ditëve, nga marrja e të gjitha përgjigjeve prej autoriteteve publike të specializuara apo miratimit në heshtje, nga ana e tyre, Autoriteti vendor përgjegjës, merr vendimin për:
 - a) lëshimin e lejes së zhvillimit;
 - b) refuzimin e lejes së zhvillimit;

dhe shprehet nëse projekt-ideja është hartuar në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe rregullat e projektimit dhe, nëse është rasti, jep vërejtjet e veta.

Leja e zhvillimit apo vendimi për refuzimin e saj i dërgohet kërkuarit nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

10 ditë nga paraqitja e kërkesës për të lëshuar lejen e zhvillimit.